

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, në lëndën penale, ndaj të pandehurit L. T. nga fshati T., të cilin e akuzon e PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.6204/13 të dt.23.03.2017, për shkak të veprës penale, Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 410 par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.25.05.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit E. J., dhe të pandehurit, me datë 25.05.2018 merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

L. T., nga i ati N., i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim në fsh. T. i V. K. Lipjan, me nr. personal *numri përsonal...*, më parë i pa dënuar, mbrohet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt. 04.09.2013, rreth orës 15:30, në oborrin e shkollës “U.”, në Lipjan, i pandehuri L. T.u, duke mos iu përfillur urdhërit të zyrtarit policor-të dëmtuarit A. A., i cili kishte kërkuar dokumentat e identifikimit dhe kishte kërkuar arsyen pse gjendet në oborrin e shkollës i pandehuri në atë moment i prezanton dokumentin e identifikimit duke kanosur të dëmtuarin me fjalët “Une numrin tënd e mora dhe kur ti ta hjekësh uniformen dhe të takoj në rroba civile atëherë ki me pa ti se kush jam unë”,-

-me këtë ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyres zyrtare nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 21, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, 410 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së të pandehurin e gjykon me,

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 1(një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

DETYROHET i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të procedurës penale t’ia paguajë shumën prej 30-€, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor shumën prej 20-euro, Fondin per viktimat e krimit në shumë prej 30.-€ këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.nr.6204/13 të dt.23.03.2017, e ka akuzuar të pandehurin L. T., për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës nga neni 410 par. 1 të KPRK-së

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhje me provat që gjenden në

shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I pandehuri ka deklaruar se e ndin vetin fajtor për veprën penale e cila i është vënë në barrë dhe njëhetir ka shtuar se në ditën kritike ka qenë i provokuar nga pala e dëmtuar se nuk ka pasur azgje të keqe me të dëmtuarin, as pas ndodhjes së këtij rasti por ajo që ka ndodhur ka ndodh rastësisht se nuk kam pasur ndonjë qëllim dhe njeherit e falënderon pa[lën e dëmtuar për mosbashkangjitje të ndjekjes penale dhe mos kërkimin e shpërblimit të dëmit dhe i premtton gjykatës që në të ardhmen nuk do të persëritë këtë sjellje, për qka i propozon që t'i shqiptohet një dënim sa më i butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës nga neni 410 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i pandehuri më parë nuk ka qenë i ndeshkuar për veper penale, rrethanat personale pra faktin se është babë i 3 fëmijëve dhe mbajtës i familjes, rrethanat pas kryerjes së veprës penale, shprehjen e keqardhjes, pendimin, premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallen e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e Financimit të Kompensimit të Viktimave të Krimit bazohet në nenin 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me kërkesen pasuroro juridike gjykata nuk vendosi për arsye se i dëmtuari konforme nenit 461 të KPPK-së, heqi dore nga e njëjta.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.

P.nr. 267/17 dt. 25.05.2018

Sekretarja juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.